Guvernatori Sejko shpjegon vendimin: Ndihmë për ekonominë, do të nxisë konsumin

Banka e Shqipërisë ul sërish normën e interesit

Banka e Shqipërisë uli sërish normën bazë të interesit, duke e zbritur atë në nivelin 1.75%, që është edhe minimumi i ri historik. Kjo është ulja e 14 me radhë e normës bazë dhe Guvernatori Gent Sejko shpjegoi arsyet se pse Këshilli Mbikëqyrës doli në këtë vendim. "Informacioni i fundit ekonomik është në linjë me pritshmëritë tona, por rritja ekonomike dhe ecuria e kredisë kanë rezultuar në kahun e poshtëm të këtyre parashikimeve. Në ndryshim nga parashikimet paraardhëse, projeksionet aktuale sugjerojnë se kthimi i ekonomisë në ekuilibër dhe inflacioni objektiv do të kërkojë një kohë disi më të gjatë. Gjithashtu, projeksionet sugjerojnë nevojën për forcimin e stimujve monetarë në ekonomi për të nxitur më tej kërkesën e brendshme dhe për të forcuar më tej kanalin e kredisë", deklaroi Guvernatori Genti Sejko. Banka priste që rritja ekonomike e këtij viti të luhatej në intervalin nga 2.5 deri në 2.7%, por sipas saj të dhënat e fundit sugjerojnë se mundësitë më të mëdha janë që rritja të jetë 2.5% dhe rikthimi i ekonomisë në ekuilibër, i parashikuar për fundin e vitit 2017, mund të kërkojë më shumë kohë. "Këshilli Mbikëqyrës konstatoi se përmbushja e objektivave të Bankës së Shqipërisë kërkon rritjen e stimulit monetar dhe ruajtjen e kahut stimulues të politikës monetare, për një periudhë më të gjatë sesa vlerësimet tona të mëparshme", shtoi Sejko. Por Guvernatori u kujdes t'i bënte të qartë qeverisë se ulja e normës bazë, edhe pse e ndihmon ekonominë, nuk i kuron problemet e saj. Këtë mund ta bëjnë vetëm reformat. "Këta stimuj monetarë, afrojnë kohën e nevojshme për kryerjen e reformave strukturore dhe zbusin koston e këtyre reformave në ekonomi, por nuk janë në gjendje që të sigurojnë rritjen afatgjatë të ekonomisë dhe nuk duhen parë si zëvendësues i këtyre reformave strukturore. Për këtë arsye, Këshilli Mbikëqyrës rithekson edhe një herë nevojën për vazhdimin dhe përshpejtimin e reformave strukturore të ndërmarra në ekonomi", tha Sejko. Mbajtja e politikës monetare në kahun lehtësues synon të nxisë konsumin dhe investimet për të pastruar tepricën e kursimeve që është krijuar në ekonomi.

Portal online për punësimet në fushën e kërkimit shkencor

Drejtori i Agjencisë, Geron Kamberi: Rëndësia e përfshirjes së Shqipërisë në rrjetin EURAXESS

Geron Kamberi, drejtor i AKTI-së

Në një intervistë për gazetën "Shqip", drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë e Inovacionit (AKTI), Geron Kamberi, tregon mbi përfshirjen e Shqipërisë në rrjetin EURAXESS, mes 40 shteteve pjesëmarrëse në të gjithë botën, një portal punësimi online në fushën e kërkimit shkencor. Përmes këtij rrjeti, tashmë të gjithë studiuesit shqiptarë mund t'i adresohen Portalit Europian në linkun www.euraxess.org dhe Portalit EURAXESS Albania në linkun www.euraxess.al, ku do të informohen për vendet e lira të punës që ofrohen në këto 40 shtete në fushën e mësimdhënies akademike, ndërkohë që e njëjta praktikë do të ndiqet edhe nga studiuesit e huaj, të interesuar për t'u punësuar në vendin tonë.

PUBLIKIMI
Gjatë vitit 2015, në këtë portal janë publikuar vetëm 4 vende vakante punësimi në fushën e kërkimit shkencor

VEPRIMTARIA
Gjatë vitit 2013-2015, AKTI ka organizuar rreth 30 ditë informative në institucione të ndryshme akademike dhe kërkimore-shkencore

Qëllimi kryesor është të sigurojë asistencë të personalizuar për studiuesit dhe kërkuesit shkencorë

Çfarë përfaqëson projekti i Rrjetit EURAXESS?

Në muajin shkurt 2011, Ministria e Arsimit dhe Shkencës nëpërmjet një letre interesi drejtuar Komisionit Europian e përcaktoi Agjencinë e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit - AKTI si Institucionin Kombëtar Koordinues për Shqipërinë në Rrjetin EURAXESS. EURAXESS është një rrjet ndëreuropian me 40 shtete pjesëmarrëse. Qëllimi kryesor i këtij rrjeti është të sigurojë asistencë të personalizuar për studiuesit dhe kërkuesit shkencorë, që lëvizin nga një vend në tjetrin për të zhvilluar karrierën e tyre akademike e kërkimore-shkencore. Në këtë kuadër AKTI ka filluar punën për ngritjen e Rrjetit EURAXESS Albania, projekt i cili do të zgjasë tre vjet, 1 tetor 2013 – 30 shtator 2016. Nëpërmjet këtij rrjeti, tashmë të gjithë studiuesit shqiptarë kanë një mundësi të marrin informacion profesional dhe personal lidhur me hapësirat konkrete që ofrojnë institucione të ndryshme universitare e qendra kërkimore shkencore të vendeve të tjera për punësim në fushën e kërkimit e mësimdhënies akademike.

A synon zbatimi i këtij projekti krijimin e një tregu për kërkimin shkencor edhe në Shqipëri?

Shqipëria është zyrtarisht pjesë e Rrjetit EURAXESS që prej vitit 2014. Një nga synimet e këtij projekti është që komuniteti i kërkuesve shkencorë në Shqipëri që punon pranë universiteteve publike e jopublike dhe qendrave kërkimore shkencore nëpërmjet prezantimit në portalin e Rrjetit EURAXESS të profilit të tyre akademik (CV-së akademike) apo të institucionit të kenë mundësi të krijojnë hapësira për informacion, rrjete e shkëmbime akademike. Në të njëjtën kohë, institucionet akademike e kërkimore shkencore në Shqipëri përmes këtij Rrjeti kanë mundësi të paraqesin pozicionet e tyre të lira të punës që kanë në departamentet e ndryshme, duke u dhënë mundësi shumë studiuesve nga vende të tjera që plotësojnë këto kritere të konkurrojnë e të jenë pjesë e stafeve akademike shqiptare. Shqipëria, si vend kandidat për në BE, duhet të fillojë të ecë gradualisht drejt saj edhe përmes një informacioni dhe transparence më të madhe mbi hapësirat për punësim, që ofrojnë institucionet akademike e kërkimore shkencore brenda tyre.

Çfarë impakti ka pasur deri më tani kjo formë e re punësimi?

Komuniteti i kërkuesve shkencorë është në hapat e parë të njohjes e familjarizimit me këtë proces që nuk ofron vetëm mundësi informimi mbi hapësirat e punësimit në institucionet akademike e kërkimore shkencore të vendeve të ndryshme. Nëpërmjet tij, secili studiues mund të gjejë informacion edhe mbi mundësitë e financimit të projekteve kërkimore shkencore, veçanërisht grantet individuale. Në rast përfitimi të një mundësie punësimi, zyrat EURAXESS të atij vendi i ofrojnë falas studiuesit një sërë informacionesh të vlefshme praktike për strehimin, sistemin e sigurimeve shëndetësor e social, shkollimin e fëmijëve. Të njëjtin funksion kryen në këtë rast edhe Rrjeti EURAXESS Albania për studiuesit e huaj që mund të punësohen në Shqipëri përmes këtij portali. Nga një pyetësor i zhvilluar në fund të vitit 2012, vetëm 17% e kërkuesve shkencorë kishin informacion mbi këtë rrjet. Gjatë vitit 2013-2015, AKTI ka organizuar rreth 30 ditë informative në institucione të ndryshme akademike dhe kërkimore-shkencore, kështu që tashmë niveli i njohjes së këtij rrjeti në Shqipëri është më i lartë.

Sa vende pune ofron Shqipëria për këtë vit?

Gjatë vitit 2015, në këtë portal janë publikuar vetëm 4 vende vakante punësimi në fushën e kërkimit shkencor, ku mund të aplikojnë kandidatë brenda dhe jashtë Shqipërisë. Theksoj se komuniteti akademik e kërkimor-shkencor në Shqipëri dhe drejtuesit e këtyre institucioneve duhet të fillojnë ta shohin Rrjetin EURAXESS si mundësi për një proces më transparent e më cilësor të punësimit të stafit akademik, veçanërisht në raport me kërkuesit e huaj që mund të kenë interes të jenë pjesë e tyre.

Për herë të parë, në Shqipëri u organizua aktiviteti "EURAXESS on tour 2015". Për çfarë shërbeu ky workshop?

Autobusi EURAXESS ndaloi në datën 15 tetor 2015 në Universitetin e Shkodrës dhe në datën 16 tetor 2015 para godinës së Universitetit Politeknik në Tiranë. I nisur nga Brukseli më datë 5 tetor 2015, ai vizitoi dy qytete në Shqipëri, Shkodrën dhe Tiranën, dhe udhëtimi i tij i plotë përfshiu 34 qytete europiane dhe 16 vende të përfshira në projektin e Rrjetit EURAXESS. Kjo ishte një nismë e Komisionit Europian, i cili u drejtohet studentëve dhe studiuesve të rinj, duke i informuar ata për mundësitë e financimit, mobilitetit dhe zhvillimit të karrierës personale.

Informaliteti

Dhoma Amerikane e Tregtisë, 12 pyetje Inspektoratit të Punës

Biznesi i integruar pranë Dhomës Amerikane të Tregtisë i ka drejtuar 12 pyetje Inspektoratit të Punës mbi regjistrimin e punonjësve, kontratat e punës, lejet e zakonshme, raportet mjekoligjore apo detyrimin për të punësuar persona me aftësi të kufizuara. Biznesi amerikan ngriti shqetësimin e penalizimit nga inspektorët, edhe në rastet kur personat e gjetur në kompani janë vizitorë apo praktikantë.

"Të gjithë duhet të jenë të siguruar, ndërsa praktikantët duhet të jenë qartazi të dukshëm dhe të identifikueshëm si të tillë. Konsiderohet si praktikant dhe jo si punonjës i padeklaruar, nëse i pari ka një marrëveshje subjekti me burimin se nga vjen ky ai", tha Irida Qosja, nga Inspektorati i Punës.

Një tjetër çështje e diskutuar në forum ishte punësimi i personave me aftësi të kufizuara. "Ne kërkojmë një integrim të këtyre personave, të vendosen në marrëdhënie pune sa të jetë e mundur, me një mirëkuptim nga të gjithë, sepse është një detyrim moral mbi të gjitha dhe sigurisht që është edhe një mundësi e juaja. Ne pa ju nuk e realizojmë dot këtë", tha Dritan Ylli, kryeinspektor i Inspektoratit të Punës.

"Ju keni caktuar që në çdo 25 persona të integrohet 1 person i tillë. Ndoshta në një numër pak më të kufizuar...?", pyeti një pjesëmarrëse. "Në rast se kjo nuk është e mundur objektivisht, mund të kryeni pagesë, është edhe kjo alternativë", tha një tjetër përfaqësues i Inspektoratit të Punës. Kreu i Inspektoratit të Punës tha se, për të shmangur abuzimet, shumë shpejt do të nisë aplikimi i inspektimit online.